

përderisa ato nuk kompletoheshin dhe për sa kohë shoqata e veteranëve të UÇK-ë nuk pajtohet me varrimin e Shabanit në ndonjërin nga varrezat e dëshmorëve të luftës.

Burimet: deklarata N.B, FDH-2595; Gjykata e Qarkut Prizren, K. num. 85/2005 (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.08.2006, FDH-33923; Gjykata Supreme e Kosovës, K.Z.371/2008, (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.04.2009, FDH-29712; AIS, *Zona...*, 23, 25, FDH-16913.

Naser (Veli) Krasniqi

(1975, shqiptar nga Ratkoci/Ratkovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Që nga mosha e tij shtatëmbëdhjetë vjeçe, Naseri punonte në Gjermani me të atin Veliun dhe vëllezërit Enverin dhe Zymberin. Pas rënies së familjes Jashari [të shikohet regjistrimi], nga mesi i muajit mars të vitit 1998, Naseri me vëllezërit aderuan në radhët e UÇK-së. Në datën **4.06.1998**, forcat serbe e hodhën një predhë mbi **Ratkocin/Ratkovac**. Naseri me tre ushtarë u nisën në vendin e ngjarjes, për të parë nëse kishte viktimë në mesin e civilëve. Kur arritën te ura, në afërsi të varrezave të fshatit, pranë tyre eksplodoi një predhë tjetër. Ciflat e saj e goditën Naserin në stomak. Pas pak, ai dha shpirt nga plagët vdekjeprurëse. Një ditë më vonë, ushtarët e UÇK-së dhe familjarët e kanë varrosur Naserin në varrezat lokale.

Burimet: deklarata R.K, FDH-33490; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 199, FDH-23816; *One Albanian Killed, Two Wounded in Serb attack in Rahovec Overnight*, pasqyra e lajmeve, KIC, 05.08.1998, FDH-29307.

Murat (Alush) Rrustemi

(20.05.1942, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Rahovecit/Orahovac)

Vëllai i Muratit, Hasani, konsiderohej në mesin e banorëve si bashkëpunëtor i policisë serbe. Ndërmjet familjes së Muratit dhe familjes së Bedri Zyberaj, njërit nga komandantët e shtabit lokal të UÇK-së, kaheerë ekzistonin disa mosmarrëveshje. Pjesëtarë të ushtrisë policore të UÇK-së [emrat e dy pjesëtarëve janë të njohur për

FDH] e kanë marrë Muratin në shtëpi më **10.06.1998**. E mbyllën në bodrumin e shkollës fillore në **Drenoc/Drenovac**. Familjarëve nuk u lejuan që të vinin për vizitë të Murati në burg. E kanë keqtrajtuar rëndë gjatë qëndrimit në burg. Pas një kohe të shkurtër, ndërroi jetë nga dëmtimet e shkaktuara nga keqtrajtimit fizike. Menjëherë pas arrestimit të Muratit, familja e tij e ka braktisur fshatin dhe ka shkuar jashtë vendit.

Në muajin prill të vitit 2009, Gjykata Supreme e Kosovës me vendim fuqiplotë i ka dënua me burgim shumëvjeçar pjesëtarët e policisë ushtarake Selim Krasniqin, Bedri Zyberajn dhe Agron Krasniqin, për shkak të ndalimit të paligjshëm dhe trajtimit çnjerëzor të Murat Rrustemit dhe të burgosurve të tjerë në burgun e UÇK-së, në Drenoc/Drenovac.

Burimet: AIS, *Zona...*, 56, FDH-16913; Gjykata e Qarkut Prizren, K. num. 85/2005 (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.08.2006, FDH-33923; Gjykata Supreme e Kosovës, K.Z. 371/2008, (S. Krasniqi dhe të tjerë), aktgjykimi, 10.04.2009, FDH-29712; SMIP, *Teroristički...*, III, 224.

Behajdin (Murteza) Allaqi

(7.04.1963, shqiptar nga Prizreni/Prizren, profesor, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Pas mbarimit të Fakultetit Filozofik në vitin 1986. godine, Behajdini ka filluar nga puna si profesor i gjimnazit shqiptar në Prizren. Jetonte në bashkësi familjare me bashkëshorten Lumnijen dhe tre fëmijë në periferi të qytetit, pranë shkollës *Lek Dukagjini*. Nga viti 1989, i vijonte studimet master në Sarajevë. Ishte sekretar i Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës. Në vitin 1993, në gjykatën e Prizrenit/Prizren, ai u dënua me dy vjet e tre muaj burgim për shkak të akuzës për veprimtari armiqësore. Aderoi në radhët e UÇK-së menjëherë pas themelimit të saj. Në datën **11.06.1998**, Behajdini u zhduk në rrethana të pasqaruara, në rrugën prej shtabit të UÇK-së në **Drenoc/Drenovac** për në shtabin kryesor, i cili gjendej në *Drenicë/Drenica*. Fati i tij nuk është ndriçuar as sot e kësaj dite. Në evidencën e të zhdukurve të KNKK-s-